



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 4170/3 Prot

Rrëshen më, 29. 12. 2025

V E N D I M

Nr. 101 datë 29. 12. 2025

PËR

**“PËRDORIM FOND REZERVË - DHËNIE NDIHMË FINANCIARE”,
BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", në Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin nr. 2, datë 24.01.2025, "Për miratimin e buxhetit 2025", VKB nr. 115, datë 27.12.2024, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025", *Kërkesën për financim nr. 4170 prot, datë 15.10.2025, relacionin nr. 4170/1 prot, datë 23.12.2025, "Mbi vlerësimin ekonomik - social të familjes të Z. Geg Gjon Shkurti", nga sektori i shërbimit social të bashkisë*, së bashku me projektin-vendimin e Kryetarit Bashkisë, shqyrtimin e miratimit në mbledhjen e datës 29.12.2025, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit, për t'a kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë, në shumën **50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë**, për dhënie ndihmë financiare, si vijon;
✚ T'i akordojë ndihmë financiare, Z. Geg Gjon Shkurti me ID; G10205144M, njësia administrative Rubik, për kushte të vështira jetese
 - a. **Paksim:** Fondi rezervë; (A1133 00 2133001 01 V491AAA...604) në vlerën;.....**50 000** lekë
 - b. **Shtohet:** Pagesë; (AA133 00 2133001 01 V111AAA...606) në vlerën;.....**50 000** lekë
2. Pagesa të kalojë me bordero, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al



KRYETAR

Aleksandër PICA KU

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN
tel dhe fax: (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË

Nr. 4170/Prot.

2

Rrëshen, më 23.12.2025

P/V E N D I M

Nr. 113 datë 23.12.2025

“PËR PËRDORIM FOND REZERVË”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’, në ligjin Nr.68/2017 ‘Për financat e vetëqeverisjes vendore’, në ligjin Nr.115/2024, ‘Për buxhetin e vitit 2025’ ‘Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 ‘Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit’, në udhëzimin Nr.2 datë 24.01.2025, ‘Për zbatimin e buxhetit 2025’, në VKB Nr.115 datë 27.12.2024 ‘Për miratimin e buxhetit të vitit 2025’, në kërkesën Nr.4252 Prot dt.11.11.2024, në relacionin Nr.4170/1 prot, datë 23.12.2025 e sektorit të shërbimit social të NJA Rrëshen, Bashkia Mirditë, këshilli i bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i bashkisë:

V E N D O S I :

I-Të miratojë përdorimin e fondit Rezervë në shumën 50 000 (Peswdhjetë mijë) lekë .) për dhënie ndihmë financiare si më poshtë:

1.T’i akordojë ndihmë financiare, Z.Geg Gjon Shkurti për kushte të vështira jetese me ID G10205144M , banuesë në Njësinë Adm.Rrëshen.

a-Paksim : Fondi rezervë (AII33 00 2133001 01 V491AAA.604) për shumën 50 000 lekë

b-Shtohet;(AA133 00 2133001 01 V111AAA.....606) për shumën50 000 lekë

2.Pagesa të kalojë në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen.

II- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari I Bashkisë (Drej.Zhv.Ek.Tat.Taksave).

III-Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

KRYETARI

Gaspër TOPOLLAJ

Aleksandër PICA KU

Paraqitën projektin

Dr/zhvill ek dhe tatim taksat:

V.Gjoka

Përgj.sek.juridik & prokurimeve

M.Topollaj

KRYETARI

Albert MËLYSHI



ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel&fax :+3552162223 web web:www.bashkiamirdite.gov.al

Nr. 4170 Prot
Dt. 15.10.25



Lënda: **Kërkesë për ndihmë financiare**

Nga: **Geg Shkurti, qyteti Rubik, njësia administrative Rubik**

Drejtuar: **Kryetarit të Bashkisë Mirditë**

Z. Albert MELYSHI

Për dijeni: **Këshillit Bashkisë Mirditë**

Të nderuar,

Unë Geg Shkurti, i datëlindjes 05.02.1961, lindur në fshatin Lufaj dhe banues në qytetin Rubik, njësia administrative Rubik, mbajtës i kartës identitetit G10205144M, paraqes kërkesën si më poshtë vijon;

Që nga muaji Maj 2025 e në vazhdim jam shumë i sëmurë, ku kam bërë 2 ndërhyrje kirurgjikale, pastrim i kockës në nofullën e majtë dhe transplant i kockës nga këmba e djathtë për t'a vendosur në nofull.

I lutem Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkisë, të ndihmojnë financiarisht për të blerë ilaqe e nevoja të tjera jetike meqenë se nuk mundem me mbuluar shpenzimet

Bashkëlidhur kërkesës;

1. Kartë identiteti (kopje)
2. Epikrizë e dokumente të tjera nga spitali që vërtetojnë gjendjen time shëndetësore

Me respekt,

Geg Shkurti

Cel. 068 57 81 276

Rrëshen, më 14.10.2025

**BASHKIA MIRDITË****AGJENCIA E ARSIMIT SPORTIT DHE NDIHMËS SOCIALE**Nr. 4170/Prot.
11Rrëshen, më 23.12.2025**Lënda:** Kërkesë për mbështetje financiare**Drejtuar:** Drejtorisë së Financës

Lidhur me kërkesën e ardhur në Bashkinë Mirditë, më 15.10.2025, me Nr. 4170 Prot. drejtuar nga zj. Geg Gjon Shkurti, i lindur në Lufaj më 05.02.1961, me NID G10205144M, për ndihmë financiare për probleme shëndetësore, ju japim relacionin si më poshtë:

Z. Geg Gjon Shkurti jeton së bashku me bashkëshorten dhe djalin e tyre 32-vjeçar në Rubik. Ata jetojnë në një banesë me kushte normale. Të ardhurat mujore të familjes sigurohen vetëm nga paga e tij, pasi ai është i punësuar në Policinë Bashkiake dhe përfiton një të ardhur mujore në vlerën 50,600 lekë, ndërsa bashkëshortja dhe djali nuk kanë të ardhura. Së fundmi, për shkak të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore, nga shkaqe natyrore, zotërisë i është dëmtuar nofulla dhe për trajtimin e saj i është nënshtruar dy ndërhyrjeve kirurgjikale, konkretisht pastrimit të kockës në nofullën e majtë dhe transplantimit të kockës nga këmba e djathtë për vendosje në nofull. Kjo situatë ka ndikuar ndjeshëm në rëndimin e gjendjes financiare dhe psikologjike të familjes, për shkak të shpenzimeve të shtuara për trajtim mjekësor dhe medikamente.

Në këto kushte, propozohet akordimi i një mbështetjeje financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve për ilaçe dhe nevoja të tjera të lidhura me shëndetin.

Konceptoi: Adela Gjikota

Miratoi: Drejtori Aurel Çupi

Përgjegjës i Sekt.Soc. Gjergj Përgjoni